

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr.6302 Prot.

Laç, me 16.12.2019

V E N D I M-SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdherit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Laç, sot me date 16.12.2019

Une, Rovena Prenga ,me detyre Permbarues Gjyqësore prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes permbarimore Nr.687 rregj. të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit Nr.-- prot Dt 15.10.2019 të Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se në datë 11.11.2019 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin së bashku me “Urdherin e Ekzekutimit” të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor) nr.1113-150 të datës 27.09.2019, të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- Debitor: Petrit Xhavit Martinaj i dtl.03.03.1980 me banim në Milot.
- Me objekt: Shpenzime procedurale në vlerën 5.000 leke + 600 leke për TFP dhe TVSH e saj..

Nga ana e zyrë tone permbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001”Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor”i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Petrit Xhavit Martinaj nuk ka marrë dijëni nëpërmjet sherbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin për shpenzime procedurale në vlerën 5.000 leke + 600 leke për TFP dhe TVSh-në mbi këto tarife, gjithsej 560 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001”Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor”,i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 16.12.2019 – 04.01.2020 të debitorit; Petrit Xhavit Martinaj i dtl.03.03.1980 me banim në Milot

2-Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kësaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Njesisë Administrative Milot, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore; Petrit Xhavit Martinaj i dtl.03.03.1980 me banim në Milot.

4-Palë debitore Petrit Xhavit Martinaj i dtl.03.03.1980 me banim në Milot, duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgji nr.4, Laç në katin e parë në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çështjes permbarimore për t’iu venë në dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me datë 16.12.2019.

PERMBARUES GJYQËSËR
ROVENA PRENGA

